

VENDIM
Nr.121, datë 19.2.2004

PËR KOMISIONIN HETIMOR PARLAMENTAR PËR TELEKOMUNIKACIONET

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për Telekomunikacionet.

II.Komisioni Hetimor Parlamentar për Telekomunikacionet ka për detyrë hetimin e veprimit/mosveprimit në zbatim të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", sidomos të të dhënave për keqadministrim, abuzim, korrupsion dhe dëmtim në forma të tjera të interesave publike në fushën e telekomunikacionit dhe në menaxhimin e Albtelekomit.

III.Komisioni Hetimor përbëhet nga:

Ilir Bano	Kryetar
Flamur Rogu	zëvendëskryetar
Fatos Beja	anëtar
Ekrem Spahia	"
Maksim Begeja	"
Arjan Starova	"
Durim Hushi	"
Mezan Malaj	"
Nazmir Bilani	"
Ardit Kraja	"
Nezir Selimi	"
Ilirian Berzani	"
Rafet Dervina	"

IV.Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej tre muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë masat e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi